



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1299/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, sh.a., (KESCO) me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.H “P...” me seli në Prishtinë, Rr. “...”, nr.1, me pronar M.H., lidhur me çështjen përmbarimore për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesën së kreditorit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti të Përgjithshme, PPP.nr.969/2017 i datës 02.07.2019, me datën 15.02.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, sh.a., (KESCO) me seli në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti të Përgjithshme, Divizioni Civil, PPP.nr.969/2017 i datës 02.07.2019, dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshme, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.969/2017 i datës 02.07.2019 e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit D.P.H “P...” me seli në Prishtinë, me pronar M.H. dhe Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.503/17 të datës 12.10.2017 në shumën prej 1,244.56€ e ka shfuqizuar për shkak të parashkrimit të kërkesës për periudhën prej datës 05.10.2013 e deri 14.09.2017.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, qe të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i takuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha P.nr.503/17 të datës 12.10.2017 ose të prishet Aktvendimi i atakuar dhe çështje ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, sh.a., (KESCO) me seli në Prishtinë, me datën 12.10.2017 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të ekstraktit nga librat afarist për konsumin energjisë elektrike të krijuar nga data 05.10.2013 deri me datën 14.09.2017 në emër të borxhit në shumën prej 1,244.56€, si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përmbartimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.503/2017, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 23.10.2017, ka ushtruar prapësim duke theksuar se me Urdhrin Përmbartimor të iniciuar në bazë të dokumentit të besueshme, përkatësisht ekstraktit nga librat afarist në të cilat evidentohet borxhi i pretenduar nga ana e kreditorit në vlerën prej 1,244.56 €, daton që nga 04.10.2013, ky borxh i pretenduar nga kreditori është parashkruar në bazë të nenit 360 paragrafi 1, nën paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-077 i LMD-së, i ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit si i themelte dhe të vërtetohet se borxhi i pretenduar nga kreditori është parashkruar dhe të refuzohet Urdhri Përmbartimor me shenjen P.nr.503/17 të datës 12.10.2017.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditore, duke theksuar se kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar, andaj i ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi Urdhri i përmbartuesit privat për caktimin e përmbartimit P.nr.503/17 dt.12.10.1017.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.969/2017, të datës 02.07.2019, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.503/2017 të dt. 12.10.2017, për shkak të parashkrimit të kërkesë për periudhën prej datës 05.10.2013 e deri me 14.09.2017, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit lidhur me parashkrimin ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 355 par.1 të LMD-së (Ligji Nr.04L-077) në shumën prej 1,244.56€ për periudhën prej datës 05.10.2013 deri 14.09.2017 pasi që debitori ka bërë pagesë të borxhit në shumën prej 160,00€ me datën 08.01.2014 që rezulton se kanë kaluar me shume së 3 vite nga pagesa e fundit deri në paraqitjen e propozimit për përmbartim me dt.12.10.2017. Prandaj, gjykata e shkallës së parë si në rastin konkret, ka

vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenin 355 par.1 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 73 të LPP –së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti nuk është i kuptueshëm, i qartë dhe se nuk përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që nuk mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përbarimore dhe për shkak të hetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e cila vihet në dyshim me pretendim ankimor, gjykata përbarimore gabimisht e ka aplikuar edhe të drejtën materiale, aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, kur e ka aplikuar depozitën e nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, pasi që parashkrimi sipas kësaj dispozite zbatohet vetëm të furnizimi i energjisë elektrike për nevoja shtëpiake. Ndërsa në rastin konkret është evident fakti se debitori është shoqëri tregtare – biznes individual ndaj të cilës nuk vlen së zbatuari dispozitat e nenit 360 të LMD-së, por në këtë rast duhet zbatuar dispozitën e nenit 355 të LMD-së, ku përcaktohet se “ *Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer*”,

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në ri procedurë pasi që ta ketë shqyrtuar dokumentin e besueshme- ekstraktin nga librat e kreditorit, të trajtojë parashkrimin sipas nenit 353 të LMD-së, ashtu që të bëjë llogaritjen e borxhit nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbushje në afat 3 vjeçar, të vlerësoj në mënyrë të drejtë nëse ka ndërprerje të parashkrimit, e pas kësaj nëse ka të përcaktojë në mënyrë të saktë periudhën kohore e cila është përfshirë në parashkrim si dhe periudhën kohore e cila nuk është përfshirë në parashkrim, duke vlerësuar kushtet ligjore nga neni 71 të LPP-së, e më pastaj ka mundësi të marr vendim të drejtë dhe në harmoni të plotë me dispozitat ligjore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika d) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.1299/22, me datën 15.02.2023**

Gjyqtari,  
Dren Rogova